

KOSOVA SOT

E ENJTE, 17 PRILL 2008, ÇMIMI 0.20 €, VITI X, NR. 3085

E PËRDITSHME INFORMATIVE E PAVARUR



U SHËNUA trevjetori i gjimnazit 'LOYOLA'

Prizren, 16 prill

Gjimnazi i Prizrenit "Loyola Gymnasium" sot ka shënuar trevjetorin e punës. Në këtë manifestim mori pjesë edhe ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj.

Komandanti i trupave gjermane në kuadër të TFSHJ-së, gjenerali Vilhem Gryn, theksoi se e ardhmja e një vendi themelohet me arsimin e mirë të nxënësve. Prandaj, është përgjegjësi e jona që të përkujdesemi për një arsim më të mirë të këtyre fëmijëve, se ata janë bazë e zhvillimit të vendit. Drejtori i kësaj shkolle, Valter Happel, tha se trevjetorin e kësaj shkolle po e kremtojmë me sukseset të cilat po vlerësohen nga të gjithë.

"Dedikimin e veçantë të falënderimit e kam për punëtorët, nxënësit dhe për kontingjentet e ushtarëve", ka theksuar ai. Festën edhe më madhështore e bëri programi i përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle. Q. TH.